



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja i) dhe 28 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16, 19 paragrafi 1.9 dhe 25 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në Deklaratën e përbashkët ndër-komunale për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve në Komunat e Mitrovicës së jugut, Vushtrrisë Podujevës dhe Skenderajt, të lidhur më 18 korrik 2019, nxjerr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRFAQËSUESVE PËR PROMOVIMIN E DIALOGUT NDËRMJET KOMUNITETEVE

Neni 1

Në funksion të komunikimit dhe përpilimit në mënyrë të rregullt të aktiviteteve që do të kenë për qëllim promovimin aktiv të dialogut dhe ndërveprimeve ndërmjet komuniteteve, Komuna e Podujevës, emëron përfaqësuesit:

znj. Donika Sfishta, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
z. Bujar Gimolli, zyrtar i lartë për komunikim me publikun

Neni 2

Të emëruarit sipas këtij Vendimi, ndër të tjera, bashkëpunojnë me përfaqësuesit e Komunave tjera nënshkruese të Deklaratës së cekur, si dhe ndërmarrin veprime dhe aktivitete të ndryshme në funksion të zhvillimit dhe rritjes së një shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike.

Neni 3


Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është deklarata e përbashkët ndër-komunale për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve në Komunat e Mitrovicës së jugut, Vushtrrisë Podujevës dhe Skenderajt, e nënshkruar nga Kryetarët e Komunave të cekura.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:
Të emëruarve,
OSBE-së (për njoftim)
Arkivit*

Nr.02-020/05-0065162/19
Podujevë, 13 gusht 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja k) dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 12 paragrafët 1 dhe 4 të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare nr. 02/I-17, nenet 19 paragrafi 1.11 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nenin 13 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, në kërkesë të datës 13.08.2019 ushtruar nga znj. Rina Kika, avokate, përfaqësuese e autorizuar e znj. Zineta Sadiku dhe sipas rekomandimit të zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e rastit në kuadër të QPS-së me nr. prot. 2008, datë 15.08.2019, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. znj. Zineta Sadiku nga Podujeva me nr. personal 1233152117, për shkak të gjendjes së rëndë sociale dhe të strehimit, për pagesë të qirasë së banimit i jepet ndihmë financiare, në shumë 1200 €, e cila jepet për periudhën gjashtë (6) mujore, me mundësi të vazhdimit, varësisht gjendjes ekonomike-sociale dhe zgjidhjes së çështjes së banimit të të përmendurës.

2. E përmendura pas kthimit nga Belgjika është cilësuar dhe trajtuar si rast i veçantë nga organet shtetërore të Republikës së Kosovës, për shkak të incidenteve që kanë ngjallur shqetësim serioz në opinionin publik, dhe për shkak të rrethanave të krijuara për sigurimin e një vendstrehimi/banimit nga ana e Komunës së Podujevës.

Neni 2

1. Ekzekutimi i pagesës bëhet në baza mujore, në shumë prej 200 € në përputhje me shumën mujore dhe kushtet kontraktuese mbi qiranë e banimit.

Si paradhënie në emër të depozitës bëhet pagesa në shumë prej 200 €.

2. Pagesa e qirasë do të bëhet vetëm pas raportimeve mujore në formë të shkruar nga ana e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e rastit në kuadër të QPS.

3. Pagesa bëhet përmes bankës në konton e qiradhësit të objektit të banimit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Vendimi i dërgohet:

-Të përmendurës & avokates (përfaqësuese e autorizuar)

-zyrtarit përgjegjës të QPS

-Arkivit

Nr.02-463/02-0066632/19
Podujevë, 16 gusht 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Njëzet e katër (24) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 2,600.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-500/01-0067592/19
Podujevë, 20 gusht 2019





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 4 dhe 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në zbatim të Vendimit nr. 01-016/01-0093084/18 për shpallje të interesit publik, i miratuar në Kuvendin e Komunës më 30.11.2018, merr:

V E N D I M P È R F U N D I M T A R

Neni 1

Miratohet shpronësimi i pjesëve të parcelave dhe disa objekteve në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim të paluajtshmërive në shtojcë të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik për realizimin e projektit *"Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet të ndriçimit, ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, ura mbi lumin Ilap(afër kompleksit banesor Malësia).*

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi të njëjtin t'ua dërgojë pronarëve ose zotëruesve të interesit në pjesë të pronave të paluajtshme të cilat preken me realizimin e projektit, dhe brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, i njëjti shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Neni 3

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave që brenda afatit prej dy (2) vite, të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pjesëve të parcelave dhe disa objekteve të shpronësuara, të përcaktuar në Aktin e vlerësimit nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme n 'kuadër të Ministrisë së Financave (shkresa nr.prot.09/271-1 datë 01.07.2019), i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi, secili pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose në të drejtat pronësore që janë objekt i këtij vendimi përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtpërdrejt në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, kanë të drejtë ankese në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr.03/L-205.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij, vendim i cili paraqet bazë juridike për regjistrime në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Pronarëve ose zotëruesve të interesit
- Arkivit

Nr. 02-464/01-0068143/19
Podujevë, 22 gusht 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nxjerr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË DATËS 07.08.2019

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për vendin e punës, pozita; **Inspektor i komunikacionit**, (nr. i referencës RN00005344), në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas konkursit nr. 13-111/01-63141/19, të datës 07 gusht 2019, ngritët Komisioni për zgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Florie Besholli, <i>udhëheqëse e sektorit për inspektive,</i> | kryesuese |
| 2. Meriton Rrahimi, <i>inspektor i komunikacionit,</i> | anëtar |
| 3. Fitim Bunjaku, <i>udhëheqës i sektorit për gjendjen civile,</i> | anëtar |
| 4. Halit Vërshevc, <i>udhëheqës i sektorit të shëndetësisë,</i> | anëtar |
| 5. Kadrije Ajvazi, <i>udhëheqëse e sektorit për buxhet dhe financa,</i> | anëtare |

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Zyrës së Personelit
Anëtarëve
Arkivës

Nr.prot.02-020/04-0069197/19
Podujevë, 26 gusht 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nxjerr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË DATËS 07.08.2019

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për vendin e punës, pozita; **Zyrtar për çështje pedagogjike** (nr. i referencës RN00005343), në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, sipas konkursit nr. 13-111/01-63141/19, të datës 07 gusht 2019, ngritet Komisioni përzgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- | | |
|---|----------|
| 1. Xhevat Llugaliu, <i>udhëheqës i sektorit për arsim,</i> | kryesues |
| 2. Adem Ajvazi, <i>zyrtar për arsimin e mesëm të ulët,</i> | anëtar |
| 3. Haxhere Ajvazi, <i>zyrtare e lartë për buxhet dhe financa,</i> | anëtare |
| 4. Mehmet Kastrati, <i>zyrtar i lartë për buxhet dhe financa,</i> | anëtar |
| 5. Blerim Nishevci, <i>zyrtar i lartë i personelit,</i> | anëtar |

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Zyrës së Personelit
Anëtarëve
Arkivës

Nr.prot.02-020/04-0069202/19
Podujevë, 26 gusht 2019


Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 2.8 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 08/2014 procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, si dhe nenin 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT- SHFMU“ KONGRESI I MANASTIRIT “ NË FSHATIN GLLAMNIK KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Sadat Abdullahu, bachelor i gjuhës dhe letërsisë shqipe-Fakulteti i Edukimit, emërohet ushtrues i detyrës së drejtorit të SHFMU “ Kongresi i Manastirit “ në fshatin Gllamnik, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet ushtrues detyre deri në zgjedhjen e drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit.

Neni 3

Kushtet e punës, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtoria e Arsimit
Të emëruarit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0069572/19
Podujevë, 27 gusht 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, nxjerr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË BRENDSHËM TË DATËS 07.08.2019

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për pozitën; ***Udhëheqës i Personelit***, në Administratën e Komunës së Podujevës, sipas konkursit të brendshëm me nr. prot. 02-111/01-63136/19, të datës 07 gusht 2019, ngritet Komisioni përzgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- | | |
|--|----------|
| 1. Ismet Uka, <i>udhëheqës i auditimit të brendshëm,</i> | kryesues |
| 2. Kadrie Ajvazi, <i>udhëheqëse e sektorit për buxhet dhe financa,</i> | anëtare |
| 3. Sabedin Namani, <i>udhëheqës i sektorit ligjor,</i> | anëtar |
| 3. Naim Salihu, <i>drejtor i shkollës së mesme,</i> | anëtar |
| 5. Nazmi Elezi, <i>udhëheqës për komunikim me publikun</i> | anëtar |

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, Rregulloren 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

Zyrës së Personelit

Anëtarëve të komisionit

Arkivës

Nr. prot.02-020/04-0070028/19
Podujevë, 28 gusht 2019

